



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAM ORIENTUES I MATURËS SHTETËRORE

PËR GJIMNAZIN

LËNDA:

“GJEOGRAFI BËRTHAMË”

(PROVIM ME ZGJEDHJE)

VITI SHKOLLOR 2020 – 2021

KOORDINATORE: EVIS MASTORI

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
HYRJE	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
STRUKTURA E TESTIT.....	5
LLOJET E PYETJEVE.....	6
TABELAT E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË.....	8

HYRJE

Lënda e gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë, ka një rëndësi të veçantë për përgatitjen e nxënësit për të jetuar dhe për t'u integruar në shoqëri, për kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar, për edukimin për të jetuar së bashku dhe edukimin për zhvillim të qëndrueshëm.

Mësimi i gjeografisë i ofron nxënësit mundësi të zhvillojë të kuptuarit e veçorive natyrore dhe shoqërore të mjedisit gjeografik, diversitetit të vendeve dhe rajoneve në botë, të njerëzve dhe kulturave, ndërvarësisë dhe ndërveprimit, si dhe marrëdhënieve të njeriut me mjedisin, në nivel lokal, kombëtar, rajonal e botëror.

Programi orientues për provimin me zgjedhje të lëndës “Gjeografi”, në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2020-2021, përbën një dokument të vlefshëm për gjimnazet, nxënësit e interesuar, mësuesit dhe specialistët e përfshirë në procesin e hartimit të testeve të Maturës Shtetërore.

Hartimi i programit orientues është mbështetur në kurrikulën me kompetenca të lëndës së gjeografisë të arsimit të mesëm të lartë duke mbajtur parasysh formimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve nëpërmjet kërkimit gjeografik në situata të thjeshta dhe komplekse.

Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së gjeografisë është mbështetur në:

- programet e lëndës së gjeografisë bërthamë për klasat 10-11;
- programin e lëndës së gjeografisë me zgjedhje për klasën e 12-të;
- udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës së gjimnazit;
- nivelet e arritjes së lëndës së gjeografisë për klasat 10-12.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën gjeografi për gjimnazin përfshin njohuritë dhe shprehitë më të rëndësishme të programeve mësimore të lëndës gjeografi për klasat 10-12.

- Programi, orienton **nxënësit** për njohuritë dhe shprehitë themelore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës gjeografi, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi, përmban informacionin e nevojshëm orientues për **mësuesit** e kësaj lënde që do të përgatisin maturantët për provimin e lëndës me zgjedhje gjeografi.
- Programi, përbën një dokument zyrtar, që duhet zbatuar me korrektesë nga **specialistët** e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të gjeografisë, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe rigorozitet nga secili prej grupeve të interesuara. Kujdes i veçantë të tregohet nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

STRUKTURA E TESTIT

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve të Maturës Shtetërore.

Testi për lëndën gjeografi do të ndërtohet në mënyrë të tillë që në të, të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel.

Në përgatitjen për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të këtij programi do të përdoren tekstet mësimore të miratuara nga MASR të kësaj lënde. Mund të përdoren edhe burime ndihmëse apo materiale shtesë, që sigurojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të programit orientues.

Bazuar në këtë kurrikul, përmbushja e kompetencave gjeografike dhe kompetencave kyçe që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës dhe jo vetëm, arrihet nëpërmjet dy tematikave kryesore: **“Proceset natyrore dhe shoqërore”** dhe **“Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve”**.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se, tematika e cila ka numrin më të madh të orëve (peshën më të madhe) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

Shpërndarja e peshave sipas tematikave

1.	Proceset natyrore dhe shoqërore	40%
2.	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	60%
	TOTALI	100%

Këto tematika, janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime e vlera. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje.

LLOJET E PYETJEVE

Pyetjet e testit të gjeografisë hartohen mbi bazën e rezultateve të të nxënit dhe testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në tematikat dhe nën tematikat e paraqitura në programin orientues.

Pyetjet që do të përdoren në testin e gjeografisë do të jenë objektive dhe subjektive.

Në **pyetjet objektive** do të përfshihen *pyetjet me alternativa* që do të testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat. Më poshtë po japim një shembull të një pyetjeje me alternativa që teston njohuritë dhe aftësitë e nxënësve për të përcaktuar se kur ndodh një eklips.

Shembull:


Nëntematika: Sistemi Diellor

Rezultati i të nxënit: Demonstron skematikisht varësinë (lidhjen) e fazave të Hënës nga pozicioni relativ i Diellit, Hënës dhe Tokës.

Përgjigja e saktë: B

Cila nga figurat tregon vendosjen e Diellit, Tokës dhe Hënës gjatë një Eklipsi Hënor?

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



Në pyetjet subjektive do të përfshihen pyetjet e strukturuar.

Pyetjet e strukturuar do të testojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve pothuajse në të gjitha tematikat dhe nëntematikat. Këto lloj pyetjesh janë pyetje të hapura, por që e kërkojnë përgjigjen në formë të strukturuar, pasi dhe kërkesat e pyetjes janë të strukturuar. Përgjigjet e pyetjeve të tilla mund të jepen duke analizuar një hartë, figurë apo grafik. Në të tilla pyetje nuk supozohet që nxënësi të japë opinionet e veta, por të përpunojë informacionin e dhuruar nga të dhënat që jepen në pyetje.


Shembull:

Nëntematika: Sistemi Diellor


Rezultati i të nxënit: Diferencon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe qarkullimit rreth Diellit.

Vëzhgoni me kujdes dy figurat:

- a) Përcaktoni në cilën nga figurat kemi të bëjmë me stinën e verës dhe në cilën me stinën e dimrit. Jepni një argument për secilin rast. **2 pikë**



- b) Supozoni se prindërit tuaj do të blejnë një apartament. Apartamenti që ata kanë zgjedhur është me drejtim nga veriu. A kanë bërë ata zgjedhjen e duhur? Jepni dy argumente për të mbështetur përgjigjen tuaj duke u bazuar në figurat e dhëna. **3 pikë**



TABELAT E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË

Për secilën tematikë dhe nëntematikë, më poshtë, paraqiten njohuritë dhe rezultatet e të nxënit që duhet të demonstrojë nxënësi për të përmbushur kompetencat gjeografike.

TEMATIKA: Proceset natyrore dhe shoqërore

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave
NËNTEMATIKA: SISTEMI DIELLOR	
<ul style="list-style-type: none"> • Toka si planet dhe tiparet e saj: <ul style="list-style-type: none"> -Forma -Përmasat • Rrotullimi i Tokës rreth boshtit: Provat dhe pasojat. • Rrotullimi i Tokës rreth Diellit, pasojat. • Hëna si trup qiellor e satelit natyror i Tokës: <ul style="list-style-type: none"> -Fazat e Hënës • Eklipsi i Hënës dhe i Diellit 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • diferencon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe qarkullimit rreth Diellit; • demonstroi skematikisht varësinë (lidhjen) e fazave të Hënës nga pozicioni relativ i Diellit, Hënës dhe Tokës; • krahason eklipsin e Diellit dhe të Hënës.
NËNTEMATIKA: HARTOGRAFIA	
<ul style="list-style-type: none"> • Paraqitja e Tokës në hartë, glob dhe plan • Rrjeti gjeografik • Brezat e kohës dhe përcaktimi i kohës lokale dhe zonale • Projektionet hartografike • Hartat, elementet matematikore dhe gjeografike 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • krahason mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan; • analizon ndërtimin e rrjetit gjeografik; • shpjegon ndryshimin e kohës lokale dhe zonale përmes përlllogaritjeve të tyre për vende me gjatësi të ndryshme gjeografike; • diferencon llojet e ndryshme të projeksioneve hartografike;

	<ul style="list-style-type: none"> • analizon elementet matematikore dhe gjeografike të hartës dhe përdorimin e tyre; • ndërton dhe interpreton profilin topografik të një sipërfaqeje të paraqitur në hartë.
NËNTEMATIKA: ATMOSFERA	
<ul style="list-style-type: none"> • Përbërja e atmosferës dhe karakteristikat kryesore të secilës shtresë • Rrezatimi diellor dhe llojet e tij • Ndikimi i rrezatimeve në sistemet gjeofizike të Tokës. • Temperatura e ajrit dhe ndryshimet e saj në kohë dhe në hapësirë • Lagështira e ajrit: kondensimi dhe format kryesore të tij • Reshjet dhe kushtet e formimit të tyre • Shpërndarja gjeografike e reshjeve dhe rëndësia e tyre • Trysnia atmosferike dhe ndryshimet e saj në kohë dhe në hapësirë • Erërat dhe llojet e tyre: erërat e qarkullimit të përgjithshëm dhe erërat lokale • Masat ajrore dhe frontet • Ciklonet dhe anticiklonet • Moti, klima dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj • Zonat klimatike 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon ndërtimin shtresor të atmosferës dhe përbërjen e saj; • interpreton ndikimin e rrezatimeve (i drejtpërdrejtë, i shpërndarë, i përgjithshëm dhe i Tokës) në sistemet gjeofizike të Tokës; • evidenton faktorët që ndikojnë në sasinë e rrezatimit që mbërrin në sipërfaqen e Tokës; • analizon llojet e rrezatimeve përmes dukurisë së përcjellshmërisë dhe konveksionit; • analizon ndryshimin në kohë dhe hapësirë të temperaturës (temperaturën mesatare ditore, mujore, vjetore, amplitudat) përmes llogaritjes dhe përpunimit të treguesve të temperaturës; • shpjegon formimin e vesës, mjegullës, brymës dhe reve, përmes procesit të kondensimit; • shpjegon kushtet e formimit të llojeve të ndryshme të reshjeve; • ndërton dhe interpreton grafikë të shpërndarjes hapësinore dhe kohore të reshjeve;

<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimet klimatike, politikat dhe masat për kontrollin e tyre 	<ul style="list-style-type: none"> • analizon ndryshimin e trysnisë atmosferike në kohë dhe në hapësirë; • analizon faktorët kryesorë që përcaktojnë drejtimin dhe shpejtësinë e erës; • shpjegon formimin e: <ul style="list-style-type: none"> - erërave të qarkullimit të përgjithshëm; - erërave lokale; • përshkruan masat ajrore dhe frontet; • bën dallimin midis ciklonit dhe anticiklonit; • analizon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës; • përcakton zonat klimatike sipas gjerësisë gjeografike dhe përshkruan veçoritë e tyre; • argumenton, me gojë ose shkrim, pasojat e ndryshimeve klimatike dhe politikat menaxhuese në nivel kombëtar e global në lidhje me to.
NËNTEMATIKA: HIDROSFERA	
<ul style="list-style-type: none"> • Hidrosfera dhe ndërvarësia me pjesët e tjera të gjeosistemit • Ujërat e deteve dhe oqeanëve, dinamika e tyre (valët detare, baticat-zbaticat, rrymat oqeanike) • Lumenjtë dhe regjimi i tyre hidrologjik • Liqenet, klasifikimi dhe evolucioni i tyre • Ujërat nëntokësorë, llojet e tyre dhe shfrytëzimi 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përmes shembujve lidhjen dhe varësinë e hidrosferës me atmosferën, litosferën dhe biosferën; • identifikoi vetitë fizike e kimike të ujit të oqeanëve dhe deteve; • shpjegoi mënyrën e formimit të valëve detare; • identifikoi elementet e valës detare; • analizon formimin e baticave dhe zbaticave e pasojat e tyre;

<ul style="list-style-type: none"> - Ujërat minerale, termominerale dhe rëndësia e tyre • Bora e përhershme dhe akullnajat 	<ul style="list-style-type: none"> • analizon rrymat oqeanike: <ul style="list-style-type: none"> - lëvizjen, - faktorët që ndikojnë në formimin e tyre, - llojet e tyre, - rëndësinë e tyre për jetën në Tokë; • interpreton karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit; • analizon regjimin hidrologjik të lumenjve; • analizon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre shoqëruar me shembuj konkretë nga bota e vendi ynë; • identifikon faktorët që ndikojnë në shndërrimin e liqeneve në kënetë; • interpreton mënyrën e formimit të ujërave nëntokësore dhe llojet e tyre; • identifikon llojet e ndryshme të burimeve; • shpjegon kushtet e formimit të borës së përhershme dhe akullnajave; • diferencon akullnajat malore dhe kontinentale.
--	--

NËNTEMATIKA: LITOSFERA

<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i brendshëm i Tokës dhe veçoritë e shtresave të saj • Mineralet, vetitë fizike dhe përdorimet e tyre • Llojet e shkëmbinjve dhe formimi i tyre • Formimi i fosileve dhe rëndësia e tyre dokumentuese 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • diferencon shtresat e Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre; • identifikon vetitë fizike të mineraleve dhe përdorimet e tyre; • klasifikon llojet kryesore të shkëmbinjve (magmatikë, sedimentarë, metamorfikë); • përshkruan kushtet e formimit të shkëmbinjve;
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> • interpreton rëndësinë e formimit të fosileve për dokumentimin e ngjarjeve dhe dukurive dhe mënyrën e formimit të tyre.
NËNTEMATIKA: DINAMIKA E TOKËS	
<ul style="list-style-type: none"> • Pllakat tektonike, lëvizja e tyre dhe forcat lëvizëse • Krijimi i tipografisë së sipërfaqes së Tokës dhe dyshemesë së oqeanit përmes tektonikës së pllakave • Lëvizjet luhatëse, rrudhosëse e shkëputëse dhe pasojat e tyre • Tërmetet dhe dukuria e formimit të tyre • Tipet e tërmeteve dhe pasojat e tyre • Shpërndarja gjeografike e tërmeteve • Vullkanet, shpërndarja gjeografike e tyre dhe pasojat e vullkaneve • Llojet e shpërthimeve vullkanike <p>Forcat e jashtme dhe ndikimi i tyre në ndryshimet në Tokë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tjetërsimi fizik, kimik e biologjik dhe kushtet në të cilat ndodhin • Dukuritë gravitative dhe faktorët e ndodhjes së tyre (shembjet, rrëzimet, rrëshqitjet) • Veprimtaria gërryese, transportuese dhe depozituese e: <ul style="list-style-type: none"> - erës dhe format e relievit që krijohen prej saj; - ujërave rrjedhës dhe format e relievit që ato krijojnë; - karstit dhe format që krijohen; 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon shpërndarjen e pllakave tektonike dhe lëvizjen e tyre; • sjell argumente pro/kundër tektonikës së pllakave; • përdor tektonikën e pllakave për të shpjeguar ndryshimin e topografisë së sipërfaqes së Tokës dhe dyshemesë së oqeanit; • analizon shkaqet e lëvizjeve dhe pasojat e tyre; • shpjegon dukurinë e formimit të tërmeteve; • diferencon tipet e tërmeteve sipas thellësisë dhe origjinës; • përdor hartën për të lokalizuar shpërndarjen gjeografike të tërmeteve; • analizon: <ul style="list-style-type: none"> - shkaqet e shpërthimit të vullkaneve; - pjesët e vullkaneve dhe produktet vullkanike; • përdor hartën për të lokalizuar shpërndarjen gjeografike të vullkaneve; • diferencon llojet e shpërthimeve vullkanike, format që krijojnë dhe pasojat e tyre;

<ul style="list-style-type: none"> - akullnajave dhe format e relievit që ato krijojnë; - detit dhe format e relievit që krijohen prej saj. 	<ul style="list-style-type: none"> • analizon: <ul style="list-style-type: none"> - kushtet në të cilat ndodh tjetërsimi fizik, kimik e biologjik; - ndikimin e tjetërsimit në ndryshimin e sipërfaqes së Tokës; • analizon kushtet në të cilat ndodhin shembjet, rrëzimet dhe rrëshqitjet; • analizon veprimtarinë gërryese, transportuese dhe depozituese të: <ul style="list-style-type: none"> - erës, - ujërave rrjedhës, - karstit, - akullnajave, - detit; • analizon pasojat globale të shkrirjes së akullnajave.
---	--

TEMATIKA: Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave
NËNTEMATIKA: EUROPA, RAJONI, SHQIPËRIA DHE TREVAT E TJERA SHQIPTARE	
<ul style="list-style-type: none"> • Trevat shqiptare: <ul style="list-style-type: none"> - përbërja dhe ndryshimet në hartën politike; - tipare të zhvillimit rajonal. • Republika e Kosovës: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet gjeografike natyrore; - tipare të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik. • Trevat e tjera shqiptare në rajon (në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në Serbi, në Greqi): <ul style="list-style-type: none"> - veçoritë natyrore; - tipare të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik; - tiparet e diferencimit në zhvillimin rajonal. • Republika e Shqipërisë: <ul style="list-style-type: none"> - pozita gjeografike dhe roli i saj në integrimin rajonal dhe europian; - ndryshimet në organizimin administrativo-territorial dhe ndikimi në zhvillimet rajonale. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Europë dhe më gjerë; • analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare; • analizon tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të Republikës së Kosovës: <ul style="list-style-type: none"> - pozitën gjeografike, - kushtet dhe pasuritë natyrore, • analizon tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Kosovës: <ul style="list-style-type: none"> - strukturën dhe ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët), - zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit; • përshkruan pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale; • analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare;

	<ul style="list-style-type: none"> • analizon dallimet që ekzistojnë në zhvillimet rajonale midis pjesëve të ndryshme të trevave të tjera shqiptare, faktorët që kanë ndikuar dhe perspektivën e zhvillimit të tyre; • vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis lindjes dhe perëndimit; • përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin administrativo-territorial të vendit tonë; • analizon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë; • argumenton ndikimin e organizimit të sotëm administrativ-territorial të Shqipërisë në zhvillimin dhe integrimin rajonal dhe europian.
NËNTEMATIKA: TIPARET E PËRGJITHSHME NATYRORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	
<ul style="list-style-type: none"> • Larmia e mjediseve dhe peizazheve natyrore të Shqipërisë • Pasuritë minerare dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve. • Larmia e formave të relievit dhe roli i relievit në ndryshimet rajonale. • Klima, elementet kryesorë klimatikë dhe tiparet e tyre. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan larminë e mjediseve dhe të peizazheve natyrore të Shqipërisë dhe faktorët e përgjithshëm që kanë ndikuar në këtë drejtim; • identifikon pasuritë minerare të vendit tonë dhe shpërndarjen gjeografike të tyre, duke përdorur hartën;

<ul style="list-style-type: none"> • Pasuritë klimatike dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve. • Larmia dhe pasuria e madhe hidrografike. • Roli dhe rëndësia e larmisë hidrografike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të veçanta të tij. • Raportet njeri-mjedis dhe ndikimi në gjendjen e peizazheve të ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • analizon rolin e relievit në zhvillimet dhe shpërndarjen hapësinore të elementeve demografike dhe ekonomike; • evidenton tiparet kryesore të klimës së vendit tonë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj; • vlerëson rolin e klimës në shpërndarjen e popullsisë dhe aktivitetet e saj; • analizon larminë dhe pasurinë e madhe hidrografike të Shqipërisë dhe faktorët që kanë ndikuar; • vlerëson rolin e pasurive hidrike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshëm; • identifikon faktorët kryesorë dhe pasojat e problemeve mjedisore në vendin tonë; • interpreton faktorët që kanë ndikuar në shkallën e lartë të degradimit dhe shkretimit të tokave si dhe pasojat e tyre; • parashikon rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi.
---	--

NËNTEMATIKA: POPULLSIA DHE EKONOMIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

<ul style="list-style-type: none"> • Popullsia dhe vendbanimet. Tiparet e zhvillimit të përgjithshëm demografik. • Ecuria e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë në periudha të ndryshme. • Tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë. • Lëvizja natyrore dhe ndikimet e saj në numrin e përgjithshëm të popullsisë. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve; • analizon ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme; • dallon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të popullsisë;
---	---

<ul style="list-style-type: none"> • Migrimet e popullsisë dhe roli i veçantë i tyre në zhvillimet demografike të vendit. • Tipare të strukturës cilësore të popullsisë së Shqipërisë (sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, etnike, fetare etj.). • Ekonomia e Shqipërisë dhe tipare të zhvillimit të saj në periudha të ndryshme. • Vlerësim i potencialeve natyrore dhe humane të vendit për zhvillimin e tij ekonomik. • Struktura e degëve dhe nëndegëve të ekonomisë. • Mundësitë dhe problematikat e zhvillimit të ardhshëm ekonomik. 	<ul style="list-style-type: none"> • analizon tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë; • interpreton grafikë, të dhëna statistikore etj., në lidhje me ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe lëvizjen natyrore të saj; • analizon procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën pas vitit 1990; • evidenton tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, referuar: <ul style="list-style-type: none"> ▪ moshës, ▪ gjinisë, ▪ vendbanimit; ▪ etnisë, ▪ fesë; • ndërton dhe analizon grafikë të strukturës së popullsisë dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të saj; • përshkruan tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, duke analizuar ecurinë e tyre përgjatë periudhave të ndryshme; • analizon rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e Shqipërisë (bujqësinë, industrinë, tregtinë, transportin, turizmin, shërbimet dhe artizanatin);
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson problemet aktuale dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, në kuadër të integritit rajonal dhe evropian.
--	--

NËNTEMATIKA: RAJONET GJEOGRAFIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

<ul style="list-style-type: none"> • Rajonizimi gjeografik i Shqipërisë. Përcaktimi i rajoneve gjeografike dhe karakteristikat e përgjithshme të tyre. • Rajoni Perëndimor: pozita gjeografike, dhe pjesët përbërëse të rajonit. • Veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe vlerësimi i tyre për zhvillimin e rajonit. • Karakteristikat kryesore të popullimit të Rajonit Perëndimor, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj. • Lëvizjet e shumta të popullsisë drejt Rajonit Perëndimor, shkaqet dhe pasojat. • Veçoritë e urbanizimit të shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij. • Tiparet e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor dhe ecuria e këtij zhvillimi në periudha të ndryshme. • Struktura e degëve dhe nëndegëve të ekonomisë së rajonit. Roli i tyre në zhvillimin e përgjithshëm. • Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të rajonit. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikon kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë, ndarjen rajonale të saj dhe tipet e rajoneve; • vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor për zhvillimin ekonomik e social të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve ndërrajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë; • përshkruan veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe potencialet natyrore për zhvillim; • evidenton karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj; • analizon shkaqet e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor dhe pasojat; • analizon urbanizimin e shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij; • interpreton grafikë, të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me ecurinë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor në periudha të ndryshme; • identifikon mundësitë dhe parashikon perspektivën e zhvillimit të Rajonit Perëndimor;
---	--

<ul style="list-style-type: none"> • Rajoni Verior-Verilindor: veçoritë kryesore natyrore dhe potencialet e shumta natyrore për zhvillimin e tij. • Pjesët përbërëse të Rajonit Verior - Verilindor dhe specifikat e tyre rajonale. • Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Verior - Verilindor (numri i popullsisë, shpërndarja e saj, struktura etj.). • Braktisja masive e Rajonit Verior - Verilindor pas vitit 1990, shkaqet dhe pasojat. • Tipare të zhvillimit ekonomik të Rajonit Verior – Verilindor. • Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Verior - Verilindor. • Rajoni Juglindor: pozicioni gjeografik dhe tiparet dalluese natyrore. • Pjesët përbërëse të rajonit dhe rëndësia ndërkufitare e tij për zhvillimin rajonal. • Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor. • Lëvizjet e fuqishme migratore të popullsisë së rajonit, veçanërisht pas vitit 1990 dhe efektet e tyre në zhvillimet rajonale. • Potencialet dhe gjendja e zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor në raport me rajonet e tjera. 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan mozaikun natyror të Rajonit Verior - Verilindor dhe potencialet natyrore për zhvillim; • identifikon tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të Rajonit Verior - Verilindor; • evidenton tiparet kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor; • analizon tendencën e ndryshimeve demografike të këtij rajoni me fokus të veçantë braktisjen pas viteve’90; • analizon tiparet kryesore të aktivitetit aktual ekonomik të Rajonit Verior - Verilindor; • identifikon mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Verior -Verilindor, rolin e korridorit Durrës-Prishtinë në kuadër të këtij zhvillimi dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë; • vlerëson pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal; • përshkruan tiparet dalluese natyrore të Rajonit Juglindor; • identifikon pjesët përbërëse të Rajonit Juglindor; • analizon tiparet dalluese dhe tendencën e zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor, me fokus të veçantë lëvizjet migratore pas viteve’90; • evidenton disa ndër pasojat e këtyre lëvizjeve në zhvillimet rajonale;
--	---

<ul style="list-style-type: none"> • Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Juglindor. • Rajoni Jugor: tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë rajonin. • Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Jugor (numri i popullsisë, shpërndarja e saj, struktura etj.). • Migrimet e popullsisë dhe pasojat e tyre në zhvillimet rajonale. • Struktura e zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj. • Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Jugor. 	<ul style="list-style-type: none"> • analizontiparetkryesoretëveprimtarisëekonomiketëRajonitJuglindor, duke e krahasuar dhe me rajonet e tjera; • identifikon mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Juglindor; • vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike ndërkufitare të Rajonit Jugor për zhvillimet rajonale; • përshkruan tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë Rajonin Jugor; • analizon tiparet dalluese të zhvillimit demografik të Rajonit Jugor; • evidenton pasojat e migrimeve të popullsisë së Rajonit Jugor; • dallon tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj; • identifikon mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Jugor.
NËNTEMATIKA: PABARAZITË DHE MUNDËSITË E ZHVILLIMIT RAJONAL	
<ul style="list-style-type: none"> • Pabarazitë në shkallën e zhvillimit socio-ekonomik midis rajoneve të vendit. • Shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e theksuara të zhvillimit rajonal, veçanërisht pas vitit 1990. • Drejtimet në të cilat shprehen pabarazitë e zhvillimit rajonal dhe rrugët për zbutjen e tyre. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet dalluese të pabarazive të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit tonë; • analizon faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e zhvillimeve rajonale; • përcakton drejtimet kryesore të këtyre dallimeve, të tilla si: <ul style="list-style-type: none"> - popullimi, - zhvillimi ekonomik,

	<ul style="list-style-type: none"> - shkalla e urbanizimit, - niveli i papunësisë, - etj.
NËNTEMATIKA: RAJONET GJEORAFIKE TË BOTËS	
<p>Europa</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tiparet e përgjithshme natyrore të Europës: <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. • Popullsia e Europës dhe karakteristika të zhvillimeve demografike: <ul style="list-style-type: none"> - ecuria e numrit të popullsisë dhe shpërndarja gjeografike; - strukturat e popullsisë në Europë. • Harta ekonomike e Europës dhe tipare strukturore të ekonomisë në Europë. • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Europë. • Nënrajonet kryesore të Europës: Europa Perëndimore, Europa Qendrore, Europa Veriore, Europa Ishullore, Europa Mesdhetare, Europa Lindore. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson rolin e pozitës gjeografike në karakteristikat e përgjithshme gjeografike të Europës dhe në marrëdhëniet me rajonet e tjera; • përshkruan veçoritë specifike rajonale natyrore të Europës: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, • analizon veçoritë e popullsisë së Europës dhe tendencat aktuale të zhvillimeve demografike në Europë; • shpjegon veçoritë kryesore të zhvillimit të sektorëve të ekonomisë europiane; • vlerëson perspektivën e zhvillimit ekonomik të Europës; • analizon veçoritë kryesore të proceseve urbanizuese në Europë dhe problemet që i shoqërojnë; • interpreton për secilin nënrajon tiparet kryesore natyrore dhe tiparet socio-ekonomike;

<ul style="list-style-type: none"> • Tiparet natyrore dhe socio-ekonomike të secilit nënrajon. 	
<ul style="list-style-type: none"> • Rusia • Tiparet e përgjithshme natyrore të Ruisë: <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. • Popullsia e Ruisë dhe karakteristika të zhvillimeve demografike. • Tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të makrorajonit rus. • Tendenca të zhvillimeve aktuale gjeopolitike të makrorajonit rus dhe perspektiva e zhvillimit të tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Ruisë në karakteristikat e përgjithshme gjeografike dhe marrëdhënien e saj me rajonet e tjera; • vlerëson rolin e pasurive të shumta natyrore që ka Rusia në zhvillimin ekonomik të saj; • identifikon veçoritë specifike rajonale natyrore të Ruisë; • analizon veçoritë e popullimit dhe tendencat aktuale të zhvillimeve demografike në rajonin rus, me fokus të veçantë shumëllojshmërinë etnike dhe shpërndarjen e popullsisë; • shpjegon veçoritë kryesore të zhvillimit të sektorëve të ekonomisë në Rusi; • vlerëson zhvillimet aktuale gjeopolitike të makrorajonit rus dhe problemet e sotme të perspektivës rajonale e globale;
<ul style="list-style-type: none"> • Amerika e Veriut • Veçoritë natyrore kryesore të rajonit të Amerikës së Veriut: <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore. • Tipare të modeleve të popullsisë së Amerikës së Veriut. 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet kryesore natyrore të rajonit të Amerikës së Veriut: <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore; • shpjegon karakteristikat e përgjithshme të zhvillimeve demografike të Amerikës së Veriut;

<ul style="list-style-type: none"> • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Amerikën e Veriut. • Modelet ekonomike të zhvillimit të Amerikës së Veriut. • Tendenca të zhvillimeve rajonale të Amerikës së Veriut. 	<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson shkallën e urbanizimit të Amerikës Veriore dhe perspektivën e zhvillimit; • analizontipet dhe llojet e ndryshme të rajoneve të SHBA-së dhe të Kanadasë, si dhe modelet e tyre të zhvillimit, duke evidentuar modelin ekonomik të zhvillimit të SHBA-së; • analizon problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Amerikës së Veriut dhe parashikon perspektivën e tyre;
<p>Amerika Qendrore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë natyrore kryesore të rajonit të Amerikës Qendrore: <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore. • Tiparet kryesore të zhvillimit historik territorial rajonal të Amerikës Qendrore. • Karakteristikat humane të rajonit të Amerikës Qendrore: <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj; - shumëllojshmëria kulturore. 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet kryesore natyrore të Amerikës Qendrore: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore; • vlerëson zhvillimin historiko-territorial rajonal të Amerikës Qendrore; • shpjegon veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Amerikës Qendrore, duke vlerësuar gërshetimin e kulturave; • identifikon veçoritë dhe shkallën e urbanizimit të Amerikës Qendrore;

<ul style="list-style-type: none"> • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Amerikën Qendrore. 	
<p>Amerika Jugore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Amerikës Jugore: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore. • Zhvillimi historik territorial rajonal i Amerikës Jugore. • Karakteristikat humane të rajonit të Amerikës Jugore: <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj - shumëllojshmëria kulturore. • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Amerikës Jugore. 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet kryesore natyrore të Amerikës së Jugut: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore; • identifikon tiparet kryesore të zhvillimit historik territorial rajonal të Amerikës Jugore; • shpjegon veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Amerikës Jugore, duke evidentuar diferencimin hapësinor të kulturave vendase dhe europiane; • vlerëson shkallën e urbanizimit të Amerikës Jugore dhe perspektivën e zhvillimit;
<p>Afrika Nënshaharane</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Afrikës Nënshaharane: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore. • Karakteristikat humane të rajonit të Afrikës Nënshaharane: <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj; - veçoritë kulturore të rajonit. 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet fiziko-gjeografike të Afrikës Nënshaharane, duke evidentuar tipizimin e botës bimore dhe shtazore: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore; • identifikon dhe vlerëson veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Afrikës Nënshaharane;

<ul style="list-style-type: none"> • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Afrikën Nënsahariane. 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan shkallën e urbanizimit të Afrikës Nënsahariane dhe perspektivën e zhvillimit të saj;
<p>Afrika e Veriut/Azia Jugperëndimore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore. • Karakteristikat humane të rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore: <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj; - kompleksiteti kulturor dhe politik i rajonit. • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Afrikën e Veriut/Azinë Jugperëndimore. • Tendenca të zhvillimeve rajonale të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore. 	<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson pozitën gjeografike të rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore; • analizon tiparet specifike të kushteve natyrore të këtij rajoni: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore; • identifikon dhe vlerëson veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore, duke u ndalur në sfidën e Islamit; • vlerëson shkallën e urbanizimit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore dhe perspektivën e saj të zhvillimit; • analizon problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore, si dhe perspektivën e tyre;
<p>Azia Jugore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë natyrore të rajonit të Azisë Jugore: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore. • Karakteristikat humane të rajonit të Azisë Jugore: 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet fiziko-gjeografike të Azisë Jugore: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore; • identifikon dhe vlerëson veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Azisë Jugore;

<ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj; - veçoritë kulturore të rajonit. • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Azisë Jugore. 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan shkallën e urbanizimit të Azisë Jugore dhe perspektivën e zhvillimit;
<p>Azia Juglindore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Azisë Juglindore: - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore. • Karakteristikat humane të rajonit të Azisë Juglindore: - popullsia dhe veçoritë e saj; - veçoritë kulturore të rajonit. • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Azisë Juglindore. • Tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të Azisë Juglindore. 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet fiziko-gjeografike të Azisë Juglindore: - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore; • identifikon dhe vlerëson veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Azisë Juglindore; • përshkruan shkallën e urbanizimit të Azisë Juglindore dhe perspektivën e zhvillimit; • analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Azisë Juglindore, me fokus modelin e zhvillimit ekonomik të një prej shteteve të ashtuquajtura “tigrat e Azisë”;
<p>Azia Lindore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Azisë Lindore: - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore. • Karakteristikat humane të rajonit të Azisë Lindore: - popullsia dhe veçoritë e saj; 	<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson pozitën gjeografike të rajonit të Azisë Lindore; • përshkruan tiparet specifike të kushteve natyrore të këtij rajoni: - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore; • identifikon dhe vlerëson veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Azisë Lindore;

<ul style="list-style-type: none"> - tiparet kulturore të rajonit. • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Azisë Lindore. • Modelet kryesore të zhvillimit ekonomik të Azisë Lindore: <ul style="list-style-type: none"> - modeli kinez, - modeli japonez. 	<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson shkallën e urbanizimit të Azisë Lindore dhe perspektivën e zhvillimit; • analizon modelet e zhvillimit ekonomik të Azisë Lindore, me fokus të veçantë modelin kinez dhe atë japonez;
<p>Australia, Oqeania</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Australisë dhe Oqeanisë: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore. • Karakteristikat humane të rajonit të Australisë dhe Oqeanisë: <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj, - veçoritë kulturore të rajonit. • Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Australisë dhe Oqeanisë. • Tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të Australisë dhe Oqeanisë. 	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet fiziko-gjeografike të Australisë dhe Oqeanisë: <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore; • identifikon dhe vlerëson veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Australisë dhe Oqeanisë; • përshkruan shkallën e urbanizimit të Australisë dhe Oqeanisë dhe perspektivën e zhvillimit; • analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Australisë dhe Oqeanisë.
NËNTEMATIKA: SFIDAT E BOTËS GLOBALE	
<ul style="list-style-type: none"> • Tendencat e sotme të popullsisë në botë: <ul style="list-style-type: none"> - ndryshimet e numrit të popullsisë dhe shpërndarja gjeografike në botë; 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikon tendencat e ndryshimit të numrit të popullsisë në botë dhe shpërndarjes gjeografike të saj;

<ul style="list-style-type: none"> - struktura e popullsisë (moshore, gjinore, sociale, profesionale). • Migrimet e popullsisë, tipet e migrimëve strategjitë rajonale dhe globale për kontrollin e tyre. • Rajonet gjuhësore dhe karakteristikat e zhvillimit, shpërndarja hapësinore e tyre dhe proceset integruese shumëkulturore. • Fetë dhe shumëkulturalizmi, shpërndarja hapësinore e besimeve fetare. • Ekonomia globale, proceset ekonomike globalizuese dhe tendenca të zhvillimit të saj. • Turizmi, llojet dhe perspektiva e zhvillimit rajonal dhe global. • Tregtia globale, roli, rëndësia dhe pasojat e saj. • Varfëria në botë, shpërndarja hapësinore dhe faktorët që ndikojnë, problematika dhe strategji globale. • Zhvillimi i qëndrueshëm, politikat rajonale dhe globale të zhvillimit, strategji që çojnë drejt tij. • Ndryshimet klimatike, pasojat që i shoqërojnë, ndikimi i veprimtarisë njerëzore dhe politikat rajonale e botërore në lidhje me to. • Ndotja si proces global. 	<ul style="list-style-type: none"> • analizon rritjen e popullsisë në vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim, faktorët që ndikojnë në këtë rritje dhe shpërndarjen e popullsisë; • analizon faktorët kryesorë që ndikojnë në proceset migratore në botë; • analizon shkaqet e migracionit të jashtëm dhe pasojat e tij përmes rasteve studimore nga vende të ndryshme; • përcakton shpërndarjen hapësinore të gjuhëve më të përhapura sot në botë dhe rajonet gjuhësore me veçoritë e tyre të zhvillimit; • tregon shpërndarjen hapësinore të besimeve fetare më të përhapura sot; • analizon faktorët që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim, shoqëruar me shembuj; • përshkruan llojet kryesore të turizmit; • identifikon rajonet turistike më të spikatura në botë dhe dallon disa ndër specifikat e tyre; • identifikon avantazhet dhe disavantazhet që shoqërojnë globalizimin e tregtisë në botë; • rajonizon shpërndarjen gjeografike të varfërisë; • analizon faktorët që ndikojnë në këtë shpërndarje; • përshkruan konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rëndësinë e tij;
---	---

	<ul style="list-style-type: none">• identifikon rrugë dhe strategji drejt një zhvillimi të qëndrueshëm industrial, bujqësor dhe urban;• analizon shkaqet dhe pasojat e ndryshimeve klimatike;• interpreton ndotjen si proces global;• vlerëson faktorët që ndikojnë dhe pasojat që e shoqërojnë.
--	---